



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017

Ref.: 550/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

V E N D I M

I. Nuk akreditohet programi i studimit i BPrAL Kolegji i Shkencave Mjekësore “Rezonanca”:

- Mjekësi e Përgjithshme, Dr. Med. 360 ECTS.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji “Rezonanca” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të programit të studimit: Mjekësi e Përgjithshme, Dr. Med. 360 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Mjekësi e Përgjithshme	Dr. Med.	360	Agim Krasniqi, Adem Haziri, dhe Nazim Dakaj

AKA ka organizuar vizitë në Kolegjin “Rezonanca” më 05.06.2017, me qëllim të vlerësimit të programit të studimit të cekur me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Danica Zeleznik dhe Helvi Kyngas.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit “Rezonanca” si dhe të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës. Ani pse rekomandimi përfundimtarë i dhënë në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër është pozitiv me kusht për një vit, ekspertët ndërkombëtarë kanë theksuar që sipas Direktivës Evropiane për programin në Mjekësi të Përgjithshme, puna praktike dhe teorike duhet të ofrohet nga një universitet, apo nën mbikëqyrjen e një universiteti. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh se Kolegji Rezonanca është kolegji, KSHC

vendosi që të marr vendim negativ për akreditimin e programit në Mjekësi të Përgjithshme në përputhje me Direktivën Evropiane dhe me dispozitën e saj se cilat institucione kanë të drejtë të ofrojnë trajnimin praktik dhe teorik të mjekësisë së përgjithshme.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit “Rezonanca”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë